URDHËR
Nr. 7790, datë 24.11.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave e të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 25.11.2016, ora 11:00, deri në datën 29.11.2016, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Eridian Salianji.

2. Ngarkohet zëvendësministri, z. Eridian Salianji, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani